

GRUPI PËR SIGURI DHE BARAZI GJINORE DËNON NGACMIMIN/SULMIN SEKSUAL TË SUPOZUAR QË PËRFSHINË FËMIJET E MOSHËS SË SHKOLLËS FILLORE DHE BËN THIRRJE PËR VEPRIME KONKRETE PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE

17 Maj 2021

Grupi për Siguri dhe Barazi Gjinore (GSBGJ) mbetet i shqetësuar dhe dënon ashpër ngacmimin/sulmin seksual të supozuar që përfshin fëmijë të moshës së shkollës fillore në një shkollë fillore në Prishtinë. Këto akte së pari janë bërë publike përmes një videoje që ka qarkulluar ditët e fundit në portalet e lajmeve dhe rrjetet sociale.

GSBGJ u bën thirrje institucioneve përkatëse të marrin masa efektive dhe të trajtojnë këtë çështje delikate me prioritetin më të madh në mënyrë që të sigurohet zero tolerancë ndaj ngacmimit seksual, dhe të garantohet siguria e fëmijëve gjatë aktiviteteve të tyre të përditshme, përfshirë edhe gjatë orëve të mësimit dhe veçanërisht brenda dhe përreth mjediseve shkollore.

Dhuna seksuale përbën një shkelje të rëndë të të drejtave themelore të njeriut dhe mbartë ndikim shkatërrues afatgjatë mbi viktimat. GSBGJ u bën thirrje institucioneve të hetojnë plotësisht krimet e tilla, duke krijuar një kulturë të tolerancës zero për ngacmimet dhe abuzimet seksuale. Fëmijët, vajzat dhe djemtë, duhet të ndihen të sigurtë në hapësirat ku mësojnë, jetojnë dhe luajnë.

Për shkak të ndjeshmërisë së kësaj çështjeje që përfshin të miturit, mediat duhet të ndalojnë shpërndarjen e filmimeve të këtij rasti në mënyrë që të mbrohet konfidencialiteti i fëmijëve.

Kosova ka bërë hapa të rëndësishëm në mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, duke përfshirë miratimin e instrumenteve kryesore të të drejtave të njeriut dhe miratimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve në vitin 2019. Zbatimi i plotë i Ligjit, duke përfshirë edhe mjedisin e shkollës, është thelbësor për të garantuar që të gjithë fëmijët të mbrohen kundër të gjitha formave të abuzimit dhe shfrytëzimit.

Kjo ngjarje që pretendohet të jetë dhunim i seksual "i izoluar" që u bë publik si dhe të tjera që mund të kenë kaluar pa u vënë re duhet të jenë një alarm për shoqërinë kosovare për të shmangur paragjykimin gjinor dhe të vlerësuar, trajtuar dhe edukuar në mënyrë të barabartë vajzat dhe djemtë në familje, në shkollë dhe shoqëri.

Kjo gjithashtu thekson nevojën për të shtuar sigurinë në objektet shkollore, të cilat duhet të kufizojnë lëvizjen e personave të cilët nuk janë nxënës dhe nxënësve, si dhe të rrisin masat e sigurisë edhe pas orëve mësimore dhe ditëve të shkollës

Më tutje, kjo çështje gjithashtu thekson nevojën për disponueshmërinë e punonjësve socialë dhe psikologëve në të gjitha shkollat në të gjithë Kosovën në mënyrë që të jenë në gjendje të parandalojnë dhe nëse ndodh, të trajtojnë çështje kaq delikate në mënyrë profesionale pa u shkakuar më shumë dëm fëmijëve të përfshirë. Puna e vazhdueshme e punonjësve socialë dhe psikologëve me fëmijët do t'i ndihmojë fëmijët të performojnë më mirë si në aspektin akademik ashtu edhe shoqëror.

Kjo gjithashtu na kujton nevojën urgjente për zbatimin e Edukimit Seksual Gjithëpërfshirës në sistemin tonë arsimor, përfshirë këtu edhe në shkollën fillore. Edukimi Seksual Gjithëpërfshirës luan një rol thelbësor në adresimin e shëndetit dhe mirëqenies së fëmijëve dhe të rinjve. Duke zbatuar një qasje të përqendruar tek nxënësi, “ESGJ” jo vetëm që iu siguron fëmijëve dhe të rinjëve arsim të përshtatshëm për moshën dhe edukimin në faza për të drejtat e njeriut, barazinë gjinore, marrëdhëniet, riprodhimin, rreziqet e sjelljeve seksuale dhe parandalimin e shëndetit të sëmurë, por gjithashtu ofron një mundësi për të prezantuar seksualitetin me një qasje pozitive, duke theksuar vlera të tilla si respekti, përfshirja, mosdiskriminimi, barazia, ndjeshmëria, përgjegjësia dhe reciprociteti.

Shënim për shtypin

Grupi për Siguri dhe Barazi Gjinore (GSBGJ) është një grup i përbërë prej shumë akterëve, i kryesuar nga UN Women. Institucionet në vijim janë anëtare të GSBGJ-së dhe e përkrahin këtë deklaratë publike:

International organizations and Embassies:

UN Kosovo Team (UNKT) agencies including the Office of the UN Development Coordinator, United Nations Entity for Gender Equality and the Empowerment of Women (UN Women), International Organization for Migration (IOM), United Nations Development Programme (UNDP), United Nations Children’s Fund (UNICEF), United Nations Human Settlements Programme (UN-Habitat), Office of the High Commissioner for Human Rights (OHCHR), United Nations Population Fund (UNFPA), World Health Organization (WHO), United Nations Office for Project Services (UNOPS), Office of the United Nations High Commissioner for Refugees (UNHCR); EU Office/EUSR, EULEX Mission in Kosovo,

Women’s organizations and NGOs:

Kosovo Gender Studies Center (KGSC), Kosovo Women’s Network (KWN), SIT - Center for Counseling, Social Services and Research, YIHR-Kosovo, Kvinna till Kvinna, Jahjaga Foundation,

Kosovo Institutions:

Agency for Gender Equality, Kosovo Police